



Npi – 01/134 datë: 03.04.2025

Duke u bazuar në nenin 12.2 shkronja (d) dhe nenin 17 shkronja (o) të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040 (“Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës” Nr.28/2008); Nenin 7, 8, 10 të Ligjit për Sistemin e Adresave në Republikën e Kosovës Nr.04/L-071; Statutin e Komunës së Shtimes 01Nr.06/1636 të datës 03.09.2008; Kuvendi i Komunës së Shtimes pasi analizoi listën e Kërkesave për emërtimin e rrugëve dhe shesheve Npi – 01/45 datë: 12.02.2025, dhe duke marrë parasysh edhe Rekomandimin e Komisionit Npi-01/60 të datës 13.03.2025, si dhe Rekomandimin e Komitetit për Politikë dhe Financa Npi-01/118 të datës 01.04.2025, Kuvendi i Komunës në seancën e mbajtur më 03.04.2025 miratoi këtë:

V E N D I M

PËR REFUZIMIN E KËRKESËS TË RRAHMAN SELMANI

I

Kuvendi i Komunës së Shtimes, në seancën e -III- të rregullt për vitin 2025, të mbajtur më: 03.04.2025, me shumicën e votave vendosi të REFUZOJË Kërkesën Nr: 06-350/02-3768/25 datë 12.02.2025, të Rrahman Selmani – Shtime, për ndrrimin e emrit të rrugës “Nazim Kokollari” me emrin “Shefki Selmani”.

II

K ë r k e s a: z.Rrahman Selmani - Shtime, Kërkesa Nr: 06-350/02-3768/25 datë 12.02.2025, ka kërkuar ndrrimin e emrit të rrugës “Nazim Kokollari” që të riemrohet me emrin “Shefki Selmani” me arsyen se kur është emërtuar kjo rrugë, nuk janë konsultuar fare banorët e kësaj lagje për këtë emërtim. Kërkesa është individuale, ka një peticion me 7 nënshkrime të familjarëve, me numër të leternjoftimit dhe mbanë titullin e banorëve të lagjës. Në këtë lagje janë 7 familje dhe të gjithë janë familjarë të Shefki Selmanit, tani të ndjerë i cili ka qenë njëri nga punëtorët më të vjetër të Institucionit Shëndetësor në Komunën e Shtimes, (QKMF) dhe i cili për shkak të punës së tijë fisnike dhe të palodhur ka gëzuar autoritet jo vetëm në mesin e bashkëpunëtorëve por edhe shumë më gjerë.

III

- A r s y e t i m: Komisioni për shqyrtimin e kërkesave për emërtimin e rrugëve dhe shesheve në komunën e Shtimes, me rekomandimin Npi-01/60, pas grumbullimit të informatave, në mbledhjen e mbajtur më më 18.12.2024, unanimisht vendosi që ti Rekomandon Kuvendit, Refuzimin e Kërkesës Nr: 06-350/02-3768/25 datë 12.02.2025, të Rrahman Selmani – Shtime, për ndërrimin e emrit të rrugës “Nazim Kokollari” në Shtime me emrin e ri “Shefki Selmani”.
- Komiteti për Politikë dhe Financa në mbledhjen e mbajtur më 01.04.2025 miratoi Rekomandimin, Npi – 01/118, me të cilin Kuvendit të Komunës i Rekomandon Refuzimin e kësaj kërkesë.
- Duke marrë parasysh të gjitha këto Kuvendi mori vendim sikurse në Dispozitiv.

IV

Ky Vendim hyn në fuqi 15 ditë nga dita e rexhistrimit në evidencën e protokolit zyrtar në MAPL, si dhe 7 ditë pas publikimit në Ueb – faqen zyrtare të Komunës së Shtimes.

V

Vendimi u dërgohet: Arkivit, Palës, Drejtorisë, Kryetarit të Komunës, Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal dhe Zyrës për Informim.



Kryesuesi i Kuvendit

Adnan Ademi